



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:133679
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05541388

KE.Nr.1899/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)Sh.A., me seli në Prishtinë, me adresë në ‘‘Sheshi Nëna Terezë’’ Nr.36, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gëzim Bërbatovci, zyrtar ligjor në KEK, kundër të paditurës Oda Ekonomike e Kosovës-Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit (TPA) me seli në Prishtinë, me adresë në ‘‘Sheshi Nëna Terezë’’, Nr.22, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.H. nga Prishtina, baza juridike e kërkesëpadisë – kërkesë për anulimin e vendimit të arbitrazhit vendor, pas përfundimit të seancës së datës 20.03.2024, me datën 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejuar padia e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)Sh.A., e paraqitur kundër të paditurit Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit (TPA), në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës.

A r s y e t i m i

Me datën 29.06.2022 paditësi Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A., ka paraqitur padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë, kundër të paditurit Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, me anë të së cilës ka propozuar që të caktohet masa e sigurisë ashtu që të ndalohet ekzekutimi i vendimit të të paditurit me numër

ARB 01/2021, i datës 24.03.2022, deri në zgjidhjen përfundimtare të kontestit sipas padisë së ngritur për anulimin e po të njëjtit vendim.

Kjo gjykatë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datën 01.11.2022 ka marrë aktvendim, me anë të së cilit ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurisë për anulimin e vendimit të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike së Kosovës me numër ARB 01/2021, i datës 24.03.2022.

Pas marrjes së vendimit lidhur me caktimin e masës së sigurisë, kjo gjykatë ka vazhduar tutje procedurën gjyqësore sipas padisë së palës paditëse, ku në padinë e parashtruar dhe në seancën e mbajtur pranë kësaj gjykate, me datë 20.03.2024, pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se konsideron që vendimi i të paditurës duhet të anulohet për faktin se procedura për lidhjen e kontratës me Kompaninë ‘‘Enertech’’ siç potencohet edhe në padi, ka qenë pjesë e hetimeve nga Policia e Kosovës ashtu që lidhur me këtë çështje nga Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda është ngritur aktakuzë ndaj zyrtarëve të KEK-ut, nën dyshimin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare lidhur me çështjen që ka të bëjë me kontratën e lidhur në mes të KEK-ut dhe ‘‘Enertech’’, e cila kontratë ka qenë objekt shqyrtimi sipas padisë në Tribunalin e Përhershëm të Kosovës.

Ai tutje ka shtuar se lidhur me ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, kundër vendimit të TPA-së, është bazuar lidhur me rentën minerare dhe se konsideron se kemi të bëjmë me shkelje të po këtij ligji andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ashtu që të anulohet vendimi i të paditurës në numrin e rastit ARB 01/2021, i datës 24.03.2022.

I padituri TPA gjatë gjykimit në këtë çështje kontestimore, ndër të tjera ka theksuar se pala mund të kontestoj aktin juridik – vendimin e nxjerrë dhe të kërkoj anulimin e tij, por nuk mund të kontestoj apo të padisë vet institucionin që e ka zhvilluar procedurën, përkatësisht TPA-në. Ka propozuar që padia të hedhet si e palejuar.

Në vlerësimin e kësaj çështje kontestimore, gjykata ka vlerësuar se Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë palë në procedurë.

Me nenin 73 të LPK-së është rregulluar se kush mund të jetë palë në procedurë kontestimore e kush jo, ku është përcaktuar si në vijim:

Neni 73.1: *“Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik.*

Neni 73.2: *Me dispozita të veçanta caktohet se kush tjetër, përpos personave fizik dhe juridik, mund të jetë palë në procedurë.*

Neni 73.3: *Gjykata e çështjes mundet, përjashtimisht, me efekt juridik në çështjen konkrete, t’ua njohë cilësinë e palës edhe atyre formave të bashkimit që nuk kanë zotësinë për të qenë palë sipas dispozitave të paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, po që se vërtetohet se, duke marrë parasysh objektin e kontestit, në esencë i përmbushin kushtet esenciale për fitimin e zotësisë për të qenë palë, e sidomos në qoftë se disponojnë me pasurinë në të cilën mund te kryhet procedura e ekzekutimit.*

Gjykata vlerëson se pala paditëse nuk ka dëshmuar para gjykatës se i padituri TPA është person fizik person juridik apo ndonjë subjekt (formë e bashkimit) që do të mund të definohej brenda kornizave të nenit 73 të LPK-së. Po ashtu, gjykata pas shqyrtimit të provave të lëndës dhe dëgjimit të palëve në procedurë ka ardhur në përfundimin se TPA nuk i plotëson kushtet e nenit 73 të LPK-së, pasi nuk është as person fizik, as person juridik, e as nuk paraqet ndonjë formë tjetër të bashkimit, sepse është themeluar nga Oda Ekonomike e Kosovës, funksionon në kuadër të saj dhe financohet nga i njëjti institucion. Duke u bazuar në këto fakte dhe rrethana, gjykata ka ardhur në përfundimin se TPA nuk mund të jetë palë në procedurë kontestimore, e rrjedhimisht edhe është hedhë padia si e palejuar.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.Nr.1899-22, datë, 03.04.2024

Gjyqtari,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të vendimit, Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së dytë, përmes kësaj Gjykate.